

NËNSHKRIMI I MARRËSHJEVE ME KFW



Nënskruhen tre marrëveshje financiare me KfW për Programin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV, me në fokus zonën bregdetare në jug të Shqipërisë. Marrëveshjet synojnë financimin e fazës së katërt të Programit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale, ku KfW, Qeveria Gjermane dhe Fondi i Investimit të Ballkanit Perëndimor do të financojnë 43.8 milionë euro. Investimet do të shtrihen në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, në bashkinë e Himarës dhe bashkinë e Vlorës, me fokus njësinë administrative Orikum. Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e zbatimit, duke e çuar numrin e përfituesve në 80,000 përfitues, përfshirë turistët.

PROJEKTI I FISKALIZIMIT



Të gjitha pagesat e biznesit do të realizohen online deri në vitin 2021. Kjo do të arrihet nëpërmjet zbatimit të projektit të Fiskalizimit, i cili ka nisur këtë vit nga MFE, me objektivi kryesor uljen e informalitetit, reduktimin e procedurave dhe burokracive, duke ndikuar në një klimë më miqësore ndaj biznesit. Në prezantimin e vëzhgimit të FIAA për mjedisin e biznesit 2019, Ministria Denaj tha se reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare prej disa vitesh kanë dhënë rezultatet e tyre të prekshme. Si rezultat i reformës së deregulimit sot 99 % e licencave jepen online, ndërsa 37 licenca po rishikohen për tu revokuar. Ministria pohoi se disa prej perceptimeve janë të drejta, pasi ndikojnë në klimën e biznesit dhe në konkurrencën e ndershme, që janë pjesë e prioritetëve të MFE.

LUFTA NDAJ INFORMALITETIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE



Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka propozuar disa ndryshime ligjore në ligjin për regjistrimin e biznesit, për procedurat tatimore dhe për masat kundër financimit të terrorizmit, të cilat synojnë adresimin e problematikave të evidentuara nga Komiteti Moneyval i KE, për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, ndryshimet synojnë reduktimin e ekonomisë informale. Një prej ndryshimeve të propozuara është detyrimi i të gjithë tatimpaguesve persona fizik/juridikë, përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse, me xhiro mbi 2 milionë lekë, për të pasur llogari bankare biznesi. Mospërbushja e këtij detyrimi do të shoqërohet me penalitete përkatëse. Ministria Denaj tha gjatë diskutimit në Komisionin e Ekonomisë se fokusi është në biznesin e ndershëm dhe reduktimin e informalitetit.

SKEMA IDEA-GRANT



Projekti ProSEED është një bashkëpunim mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe GIZ për rritjen e punësimit dhe zhvillimin e SME-ve. Në zbatim të këtij projekti u zhvillua ceremonia e ndarjes së granteve të skemës IDEA-Grant, e cila mundëson mbështetje financiare për fillimin e biznesit përkatësisht në vlerën 4.000 € për projekte individuale dhe 7.000 € për projekte në grup. 43 përfitues janë përzgjedhur për periudhën Shtator 2018-Prill 2019, të cilëve do tu akordohen rreth 25 milionë lekë. Shuma totale e buxhetuar për skemën IDEA-Grant është 500.000 euro, do të ofrohen deri në 110 grante për sipërmarrësit aspirues dhe bizneset ekzistuese, duke përfshirë një përqindje prej 40% për gratë dhe të paktën 20% për emigrantët e kthyer.

MBËSHTETJA E GRAVE SIPËRMARRËSE



Numri i bizneseve që drejtohen nga gratë ka adhur gjithnjë në rritje dhe sot 33 % e bizneseve të vogla dhe të mesme drejtohen nga gratë, ku bizneset e vogla dhe të mesme zënë rreth 98-99 të numrit total të bizneseve. Në konferencën "Gratë sipërmarrëse – Sfidat dhe Qasjet që ofron tregu" u konfirmua angazhimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për fuqizimin e rolit të gruas në sipërmarrje, e në këtë drejtim MFE ka edhe një Plan Veprimi për Gratë Sipërmarrëse. Gjithashtu, nëpërmjet fondeve që menaxhohen nga AIDA, MFE mbështet bizneset me fonde, përfituese e të cilave janë edhe gratë sipërmarrëse, si fondi i konkurrueshmërisë, fondi i kreativitetit, fondi i artizanatit, start –up.

SHËRBIM I RI ONLINE PËR TATIMPAGUESIT



Një shërbim i ri elektronik është shtuar për tatimpaguesit. Çdo sipërmarrës tashmë ka mundësinë të kryejë online aplikimin për "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (eSig25)", e cila i mundëson tatimpaguesve pajisjen me listëpagesën e njehsuar me vullë elektronike, në çdo kohë dhe pa asnjë kosto, përmes platformës elektronike e-Albania, duke i shmangur tatimpaguesve paraqitjen fizike në sportelet e Qendrave të Shërbimit. Ky shërbim i ri i shtohet portofolit me 9 lloje vërtetimesh (7 për subjekte tatimpagues dhe 2 për individë) me vullë dixhitale, që Administrata Tatimore ofron online, përmes portalit e-Albania.

TAKIM ME STUDENTËT EKSELENTË PUNËSUAR NË MFE



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, zhvilloi një takim me studentët e ekselencës që janë punësuar pranë MFE. Në këtë takim u nda eksperiencia e muajve të parë të punësimit të tyre në administratë, angazhimet, nismat dhe rezultatet e para. U diskutua mbi idetë dhe sugjerimet e tyre se si mund të adresohen politika cilësore në funksion të ndërtimit të një ekonomie moderne dhe të qëndrueshme. Mbështetja ndaj të rinjve të talentuar në rrugëtimin e tyre profesional në administratën publike është detyrim ndaj rritjes së kapaciteteve të administratës dhe detyrim në vetvete mbi të ardhmen e vendit.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



565 persona janë punësuar nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të punës në të gjithë vendin gjatë periudhës 31 maj- 6 qershor. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 163 persona dhe qarku i Vlorës me 152 persona. Gjatë kësaj jave është organizuar dhe Panairi i Punës Gjirokastër 2019. Rreth 40 kompani nga Gjirokastra, Tepelena dhe Përmeti prezantuan në panair 416 vende të lira pune, në sektorë si: hoteleri-turizëm, industri përpunuese, ndërtim, punime artizanale, shërbime transporti, tregtare, apo telekomunikacioni, duke intervistuar kandidatët të ndryshëm, me synim rekrutimin e një fuqie punëtore të kualifikuar.